



Organizata e Veteranëve të Luftës të - UÇK - së
Shoqata e Invalidëve të Luftës të UÇK - së
Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK - së



Të nderuar invalidë, veteranë të luftës dhe familjarë të dëshmorëve
I nderuar popull i Mitrovicës dhe rrethinës
Të nderuar të gjithë Ju që jeni bashkangjitur në këtë protestë

Sot ne u tubuam në Mitrovicë, të bashkuar e të vendosur për të kundërshtuar shkeljen e vazhdueshme, që po i bëhet sovranitetit të Kosovës, nga ata të cilët u larguan turpshëm dhe të humbur nga Kosova. Jemi dëshmitarë të vuajtjeve, nëpër të cilat ka kaluar populli i Mitrovicës dhe rrethinës në dekadën e fundit. Jemi dëshmitarë, të absurdit, i cili mbase është shembulli i vetëm në botë, kur njeriu është refugjat në qytetin e vet. Deri kur do të zgjas mos efikasiteti i organeve kompetente, për të vendosur ligjshmërinë në tërë territorin e Kosovës? Qe nga përfundimi i luftës çlirimtare, gjithëherë dhe nga secila qeveri, nga secili shef i UNMIK-ut e tash edhe nga EULEX-i kemi dëgjuar premtimin për bashkimin e qytetit. Pas shpalljes së pavarësisë, ne shqiptarët pranuan edhe kompromisin për 2 komunat, me qëllimin më të mirë se do të bëhet kthimi i njerëzve në pronat e tyre dhe të sigurohet qarkullimi i tyre i lirë. Dhe çfarë gjendje kemi sot? Nuk është realizuar asgjë, e çka është edhe më keq, ata pak vëllezër që jetojnë përtej Ibrit, keqtrajtohen dhe iu bëhet jeta e vështirë edhe në oborrin e tyre.

Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, dhe kategoritë që ato përfaqësojnë, si më të merituarat për lirinë e Kosovës, që nga pas lufta, janë vënë në shënjestrën e misionëve ndërkombëtare. Por ne, me gjakftohtësi, i kemi përballuar sfidat që kishim, duke peshuar dhe reaguar sipas nevojës së kohës, ndërsa mosorganizimi i protestave nga ne, e ka pasur urtësinë e vet, në mënyrë që t'i ipet kohë faktorëve relevantë që të zgjedhin çështjet sipas asaj që kanë premtuar.

Por tani, heshtja është thyer, durimi ka përfunduar dhe ne nuk do të lejojmë pazaret e ndryshme që e favorizojnë Serbinë dhe strukturat e saja ilegale në Kosovë. Ne jemi lodhur nga neglizhenca njëdekadëshe e faktorëve ndërkombëtar si dhe nga institucionet e Kosovës. Ata shkojnë në drejtim të filozofisë së ambientimit, dhe shndërrimin e popullit të Kosovës, në popull të dëgjueshëm ndaj urdhërave të të tjerëve. Këtë

filozofi, UÇK-ja me armë dhe gjak, e ka hudhur njëherë e përgjithmonë në plehun e mbeturinave historike.

Kjo neglizhencë, na bën të kuptojmë, se po shkaktohet me qëllim nga misionet ndërkombëtare, që ta lëjnë Kosovën gjithëherë si vatër të krizës, në mënyrë që ta zgjasin jetën e tyre këtu.

Serbisë dhe elementeve proserbe në Evropë, iu pëlqen që Kosova të mbetet gjithnjë problem i pazgjidhur sikur Qiproja e Palestina.

Por ne, me gjakun e mijëra dëshmorëve dhe me përpjekjet e dhjetëra mijëra luftëtarëve e aktivistëve, kemi mundur Serbinë edhe politikisht e edhe ushtarakisht. Duke u nisur nga ky fakt, për ne janë të patolerueshme rrjedhat negative të ngjarjeve dhe vazhdimi i lejimit të ekzistimit të strukturave ilegale të një shteti tjetër brenda territorit sovran të Republikës së Kosovës.

Ne kërkojmë nga KFOR-i, EULEX-i dhe qeveria e Kosovës,

Që të përdorin mekanizmat e tyre të sigurisë në mbrojtje të sovranitetit të Kosovës: duke mbrojtur e ruajtur kufinj shtetëror, duke kthyer banorët e zhvendosur në pronat e tyre, duke vendosur rendin e ligjin në tërë territorin sovran të Kosovës. Ne vazhdojmë të besojmë, se faktorët relevantë do të gjejnë një zgjidhje paqësore dhe të shpejtë.

Në të kundërtën, veteranët e luftës nuk do të qëndrojnë duarkryq. Në ditët në vazhdim, ne do të përcjellim dhe analizojmë rrjedhën e ngjarjeve, e nëse nuk zbatohen kërkesat tona, atëherë, ta dini se kjo protestë është vetëm fillimi i angazhimeve për mbrojtjen e sovranitetit.

Strukturat ilegale dhe shefat e tyre që hyjnë në Kosovë si në bashqen e vet, do të përballen me reagimin tonë. E reagimi ynë do t'i turpërojë edhe me keq sesa në vitin 1999. Do të binden që luftëtarët e lirisë janë më të fortë e me të mobilizuar se kurrë më parë

Ju falenderoj për pjesëmarrjen

Rroftë Kombi Shqiptar

Rroftë Ushtria Çlirimtare e Kosovës

Mitrovicë, më
30 maj 2010

Këshilli Organizues i Protestës
Kryetari Muharrem Xhemajli